

Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen

Raportimet Financiare për tremujorin III 2024 për
Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare

Tetor 2024

Pasqyrat financiare të Raiffeisen Invest -Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	
Informacioni	Përshkrimi, vlera
Kodi i shoqërisë administruese	K5192800II
Numri i regjistrimit në QKR	
Numri për raportimin	1
Adresa	Rruga Tish Daija,Kompleksi Kika2,Tirane
Telefon/fax	+355 694040481
Email:	Alketa.gjocaj@raiffeisen.al
Faqe Web	www.raiffeisen-invest.al
Data e licensimit	18 Tetor 2010
Emri dhe mbiemri i Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Administrativ	Donalda Gjorga - Kryetare
	Peter Zilinek-Zv.Kryetar
	Juela Ahmeti-anëtare
	Elona Llaci-anëtare
	Gentjana Ciceri-anëtare
	Alketa Emini-anëtare
	Edlira Konini-anëtare
Pesë aksionerët më të mëdhenj (emri,mbiemri, adresa, ose emri i shoqërisë dhe adresa e zyrtare, përqindja e aksioneve në pronësi)	
Emri i shoqërisë	Raiffeisen Bank Albania
Adresa zyrtare	Rruga e Kavajes
Përqindja e aksioneve	100%
Numri i punonjësve	15
Shoqëria e ekspertit kontabël që ka audituar e fundit pasqyrat financiare	Deloitte Audit Albania Sha
Banka (depozitari) me të cilin kryen veprimet shoqëria e administrimit	First Investment Bank, Albania
Numrat e llogarive:	
Nr e llogarive të Shoqërisë Administruese:	
Raiffeisen Bank	AL75 2021 1037 0000 0000 0095 9145
Raiffeisen Bank	AL34 2021 1013 0000 0001 0495 9145
First Investment Bank Albania	AL18 2151 1031 ALL1 0000 0401 7500
Nr e llogarive të Fondit të Pensionit Vullnetar Raiffeisen:	
First Investment Bank Albania	AL78 2151 1031 ALL1 0000 0393 3000
First Investment Bank Albania	AL93 2151 1031 ALL5 3000 0393 3000
Nr i llogarisë të Fondit të Investimit Raiffeisen Prestigj:	
First Investment Bank Albania	AL43 2151 1031 ALL1 0000 0524 4100
Nr i llogarisë të Fondit të Investimit Raiffeisen Invest Euro:	
First Investment Bank Albania	AL03 2151 1031 EUR1 0000 0610 6600
Nr i llogarisë të Fondit të Investimit Raiffeisen Vizion:	
First Investment Bank Albania	AL60 2151 1031 ALL1 0000 1172 3200
Nr i llogarisë të Fondit të Investimit Raiffeisen Miks:	
First Investment Bank Albania	AL32 2151 1031 EUR1 0000 1473 1900
Nr i llogarisë të Fondit të Qëndrueshëm Raiffeisen Solid	
First Investment Bank Albania	AL48 2151 1031 EUR1 0000 1987 3000

Pasqyrat financiare të fondit të pensionit privat

1. Pasqyra e aktiveve të fondit të pensionit privat

Emri i fondit të pensionit privat: **Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen**

Kodi i fondit të pensionit privat: **FPI**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **30/09/2024**

	Lek	Lek
Zërat e aktivitet	31/12/2023	30/09/2024
1. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare , depozite	16,961,269.07	9,853,556.59
2. Investime (2a+2b+2c+2d+2d)	1,353,709,184.19	1,560,558,462.21
2a. Letra borxhi të blera në emetimin e parë	1,088,431,791.45	1,234,778,788.20
2b. Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes		
2c. Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet te ardhurave gjithëpërfshirëse	16,060,751.19	16,559,190.09
2d. Investime financiare të mbajtura deri në maturim	1,072,371,040.26	1,218,219,598.11
2a. Letra borxhi të blera në treg sekundar	265,277,392.74	325,779,674.01
2b. Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes		
2c. Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet te ardhurave gjithëpërfshirëse		
2d. Investime financiare të mbajtura deri në maturim	265,277,392.74	325,779,674.01
2e. Depozita		
3. Llogari të arkëtueshme	30,312,022.71	18,010,421.43
3a. Të arkëtueshme nga shitja e letrave me vlerë		
3b. Të arkëtueshme nga shoqëria administruese		
3c. Të arkëtueshme nga depozitari		
3d. Parapagime		
3e. Të arkëtueshme nga ndryshimi i anëtarësisë		
3f. Të tjera llogari të arkëtueshme	30,312,022.71	18,010,421.43
A (1+2+3) TOTALI I AKTIVEVE	1,400,982,475.97	1,588,422,440.23
4. Detyrime nga investimi në letrat me vlerë		
5. Detyrime nga investimi në depozita		
6. Detyrime ndaj shoqërisë administruese	1,793,572.94	3,231,377.54
7. Detyrime ndaj depozitarit		
8. Detyrime nga ndryshimi i anëtarësisë (shlyerje)	284,430.48	24,320.34
9. Pagesa të shtyra dhe të ardhura të marra në avancë		
10. Detyrime të tjera	2,371,959.95	3,263,045.65
B (4+5+6+7+8+9+10) TOTALI I DETYRIMEVE	4,449,963.37	6,518,743.53
C (A-B) AKTIVET NETO TË FONDIT TË PENSIONIT	1,396,532,512.60	1,581,903,696.70
D Numri i kuotave të fondit të pensionit të emetuara	650,971.6360	712,953.4519
E (C/D) AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË PENSIONIT	2,145.3047	2,218.8036

2. Pasqyra e veprimtarisë së fondit të pensionit privat

Emri i fondit të pensionit privat: **Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen**

Kodi i fondit të pensionit privat: **FPI**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **30/09/2024**

		30/09/2023	30/09/2024
Nr.	Zerat		
	TË ARDHURA NGA INVESTIMET		
1	Fitime të realizuara nga shitja e investimeve në letra me vlerë	38,621.51	14,641.83
2	Të ardhura nga interesat	56,196,725.97	66,380,599.86
3	Diferenca pozitive të kurseve të këmbimit nga mjetet monetare		
4	Të ardhura nga dividendët		
5	Të ardhura të tjera	1,478,650.05	1,426,402.08
A (1+2+3+4+5)	TOTALI I TË ARDHURAVE NGA INVESTIMET	57,713,997.53	67,821,643.77
	SHPENZIMET		
6	Humbje të realizuara nga shitja e investimeve në letra me vlerë	19,813.97	1,438.15
7	Diferenca negative të kurseve të këmbimit nga mjetet monetare	-	
8	Tarifa për shoqërinë administruese	14,333,494.68	16,664,754.31
9	Tarifa për depozitarin	-	
10	Shpenzime të tjera	1,498,148.19	1,619,140.09
B (6+7+8+9+10)	TOTALI I SHPENZIMEVE	15,851,456.84	18,285,332.55
C (A-B)	FITIMI (HUMBJA) NETO NGA INVESTIMET, +/-	41,862,540.69	49,536,311.22
	FITIMI (HUMBJA) E PAREALIZUAR NGA INVESTIMET NË LETRA ME VLERË		
d1	Fitimi (humbja) e parealizuar nga investimet në letra me vlerë, +/-	-	47,928.92
d2	Ndryshime neto prej kurseve të këmbimit në investimet në letra me vlerë		
d3	Amortizimi i primit/diskountit të aktiveve me afat maturimi fiks.	- 250,072.72	- 56,755.03
d4	Zhvlerësim i aktiveve	- 29,586.09	- 560.87
D (d1+d2+d3+d4)	TOTALI I FITIMEVE (HUMBJEVE) TË PAREALIZUARA NGA INVESTIMET NË LETRA ME VLERË, +/-	- 279,658.81	- 105,244.82
E (C+D)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NETO I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT	41,582,881.88	49,431,066.40
E (C+D)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NETO I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT	41,582,881.88	49,431,066.40
F	TE ARDHURA GJITHPERFSHIRESE		
	Zërat që mund të riklasifikohen më pas në fitim ose humbje:		
a)	Letra te vlefshme per shitje:		
	Fitimet / humbje që lindin gjatë vitit	925,350.49	555,754.80
b)	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		
	TOTALI I TE ARDHURAVE GJITHPERFSHIRESE	925,350.49	555,754.80

3. Pasqyra e ndryshimeve në asetet neto

Emri i fondit Emri i fondit të pensionit privat: **Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen**

Kodi i fondit Kodi i fondit të pensionit privat: **FP1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhë Për periudhën: **30/09/2024**

		Lek	Lek
		31/12/2023	30/09/2024
	Zërat		
	RRITJA (ZVOGËLIMI) I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT		
1	Fitimi (Humbja) neto nga investimet, +/	56,864,537.03	49,536,311.22
2	Totali i fitimeve (humbjeve) të përcaktuara nga investimet në letra me vlerë	- 81,833.11	- 105,244.82
3	Rivlerësimi i aktiveve financiare me vlerë të drejtë ndërmjet te ardhurave gjithpërfshirëse	854,204.75	555,754.80
A (1+2+3)	RRITJA (ZVOGËLIMI) I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E	57,636,908.67	49,986,821.20
4	Kontribute nga anëtarët e fondit	173,298,728.39	182,014,543.93
5	Tërheqje për shkak të ndryshimit të anëtarësisë	- 2,978,249.56	
6	Terheqje e menjehershme pa mbushur moshën e pensionit (terheqje te parakohshme)	- 28,668,147.13	- 31,422,188.05
7	Terheqje e perfitimeve te pensionit mujor	-	- 4,125,518.78
8	Tërheqje e menjehershme e perfitimeve te pensionit	- 13,862,700.70	- 11,082,474.21
B (4-5-6)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NË TOTAL NGA TRANSAKSIONET ME KU	127,789,631.00	135,384,362.89
C (A+B)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NË TOTAL I AKTIVEVE NETO, +/-	185,426,539.67	185,371,184.09
D	AKTIVET NETO		
9	Në fillim të periudhës	1,211,105,972.96	1,396,532,512.60
10	Në fund të periudhës	1,396,532,512.63	1,581,903,696.69
	NUMRI I KUOTAVE TË PENSIONIT		
11	Kuota të pensionit të emetuar mbi bazën e kontributeve	82,536.98	83,375.15
12	Kuota e pensionit të tërhequra mbi bazën e ndryshimit të antarësisë	- 1,412.43	
13	Kuota për tërheqjet menjehershme pa mbushur moshën e pensionit /te parakohshme	- 13,681.43	- 14,419.62
14	Kuota të tërheqjeve të pensioneve mujore	-	- 1,882.40
15	Kuota të tërheqjeve të pensionit në mënyrë të menjehershme te perfitimeve te pensionit	- 6,619.82	- 5,091.32
E (9-10-11)	NUMRI I KUOTAVE TË PENSIONIT	60,823.31	61,981.82

4. Pasqyra mbi kuotat e fondit të pensionit privat

Emri i fondit të pensionit privat: **Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen**

Kodi i fondit të pensionit privat: **FP1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **30/09/2024**

	Numri i kuotave të fondit	Aktivet e fondit (Lek)	Aktive për kuotë (Lek)
Lloji			
Në fillim të periudhës 31.12.2023	650,971.6360	1,396,532,512.6008	2,145.3047
Emetuar gjatë periudhës	83,375.1549	182,014,543.9300	2,183.0789
Tërheqje për shkak të ndryshimit të anëtarësisë			
Terheqje e menjehershme pa mbushur moshën e pensionit (terheqje te p	14,419.6192	31,422,188.0500	2,179.1275
Terheqje e perfitimeve te pensionit mujor	1,882.4000	4,125,518.7800	2,191.6271
Tërheqje e menjehershme e perfitimeve te pensionit	5,091.3198	11,082,474.2100	2,176.7390
Në fund të periudhës 30.09.2024	712,953.4519	1,581,903,696.6953	2,218.8036

5.2 Pasqyra e strukturës së investimeve -Obligacioneve

Emri i fondit të pensionit privat: **Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen**

Kodi i fondit të pensionit privat: **FP1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **30/09/2024**

Lloji	Tregu Primar Secondar	Vlera nominale (Lekë)	Shpenzimet e blerjes (Lekë)	Vlera në datën e raportimit pa interesat e përlogaritura. Vlera e tregut (Lekë) 30/09/2024	Vlera kontabël (Lek) 30/09/2024	Pjesa ndaj kapitalit të emetuesit, %	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit, %
Obligacione të Qeverisë (brenda vendit)		1,561,200,000.00	1,560,606,391.10	1,560,558,462.21			98.25%
AFS		16,500,000.00	16,559,190.09	16,559,190.09			1.04%
HTM		1,544,700,000.00	1,544,047,201.01	1,543,999,272.12			97.20%
TOTALI I OBLIGACIONEVE TË		1,561,200,000.00	1,560,606,391	1,560,558,462			98.25%
Obligacione të shoqërive (brenda vendit)							
Obligacione të Qeverive (jashtë vendit)							
Obligacione të shoqërive (jashtë vendit)							
OBLIGACIONEVE TË EMETUESVE TË HUAJ							

5..6 Pasqyra e strukturës së investimeve - Investime të tjera

Emri i fondit të pensionit privat: **Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen**

Kodi i fondit të pensionit privat: **FP1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **30/09/2024**

	Vlera në datën e raportimit (Lek)	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit, %
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (brenda vendit)	9,853,556.59	0.62%
Aktive të tjera (brenda vendit)		
TOTALI BRENDA VENDIT	9,853,556.59	0.62%
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (jashtë vendit)		
Aktive të tjera (jashtë vendit)		
TOTALI JASHTË VENDIT		

6. Pasqyra e treguesve të portofolit të fondit të pensionit privat

Emri i fondit të pensionit privat: **Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen**

Kodi i fondit të pensionit privat: **FP1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **30/09/2024**

obligacione maturiteti i mbetur	deri në 1 vit	nga 1 deri në 2 vjet	nga 2 deri në 3 vjet	nga 3 deri në 5 vjet	nga 5 deri në 7 vjet	më shumë se 7 vjet	Totali
vlera (leke)	103,813,441.26	126,195,075.34	84,887,348.40	290,831,556.82	299,005,338.22	655,825,702.16	1,560,558,462.21
ne %	6.65%	8.09%	5.44%	18.64%	19.16%	42.03%	100.00%
Modified Duration	4.99						

7. Pasqyra e fitimeve (humbjeve) të realizuara të fondit të pensionit privat

Emri i fondit të pensionit privat: **Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen**

Kodi i fondit të pensionit privat: **FP1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **30/09/2024**

Tituj të shitur/maturuar	ISIN	Data e shitjes	Numri i letrave me vlerë	Vlera kontabël (Lek)	Çmimi i shitjes dhe maturimit (Lek)	Fitimi (Humbja) e realizuar (Lek)
1	2	1	3	4	5	6 (5-4)
Obligacione të Qeverisë			58,500,000.00	58,486,796.32	58,500,000.00	13,203.68
HTM			58,500,000.00	58,486,796.32	58,500,000.00	13,203.68
	AL0018NF7Y24	03.03.2024	23,100,000.00	23,098,840.73	23,100,000.00	1,159.27
	AL002NF10Y24	24.01.2024	4,500,000.00	4,499,878.72	4,500,000.00	121.28
	AL0019NF7Y24	01.06.2024	17,000,000.00	16,987,559.03	17,000,000.00	12,440.97
	AL003NF10Y24	25.04.2024	6,000,000.00	5,999,553.88	6,000,000.00	446.12
	AL004NF10Y24	25.07.2024	7,900,000.00	7,900,963.96	7,900,000.00	-963.96
HFT						
AFS						
Boni thesari						
Obligacione të Shoqërive						
HTM						
HFT						
AFS						
Fonde të indeksuara						
Tituj të tjere						
Totali i fitimit (humbjes) se realizuar			58,500,000.00	58,486,796.32	58,500,000.00	13,203.68
Ripermbledhja sipas kategorive të aseteve financiare			58,500,000.00	58,486,796.32	58,500,000.00	13,203.68
Fitimi (humbje) të realizuara nga astete financiare me vlera të drejte						
Fitimi (humbje) të realizuara nga astete financiare të disponueshme për shitje						
Fitimi (humbje) të realizuara nga astete financiare të mbajtura në maturim			58,500,000.00	58,486,796.32	58,500,000.00	13,203.68

9. Pasqyra e fitimeve (humbjeve) të përcaktuara të fondit

Emri i fondit të pensionit privat: **Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen**

Kodi i fondit të pensionit privat: **FP1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **30/09/2024**

	ISIN	Data e blerjes	Shpenzimet e blerjes	Vlera e tregut 30.09.2024 (Lek)	Rivlerësimi i aktiveve të të mbajtura përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse	Ndryshimi neto në vlerën e investimit nga kursi i këmbimi	Amortizimi i primit/ diskontit të aktive me afat maturimi fiks	Zhvlerësimi i aktiveve
Obligacione të Qeverisë			1,560,606,391	1,560,558,462			-47,929	
HTM			1,544,047,201	1,543,999,272			-47,929	
HFT								
AFS			16,559,190	16,559,190	0			
Obligacione të Shoqërive								
HTM			0	0			0	
AFS								
Fonde të indeksuara								
Tituj të tjerë								
Totali i fitimit (humbjes) të përcaktuar			1,560,606,391	1,560,558,462	0		-47,929	
Ripërmblidhja sipas kategorive të aseteve financiare								
Fitimi (humbje) të realizuara nga astete financiare me vlerë të drejte								
Fitimi (humbje) të realizuara nga astete financiare të disponueshme për shitje			16,559,190.09	16,559,190	0			
Fitimi (humbje) të realizuara nga astete financiare të mbajtura në maturim			1,544,047,201.01	1,543,999,272			(47,928.89)	

11. Tabela e kontratave të fondit të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur

Emri i fondit të pensionit privat: **Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen**

Kodi i fondit të pensionit privat: **FP1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **30/09/2024**

Planet e pensionit	Nr
Numri i kontratave individuale të pensionit privat	1395
Numri i kontratave midis punëdhënësve dhe shoqërisë administruese për anëtarësimin e punëmarrësve në fondin e pensionit me pjesëmarrje të hapur	32

13. Tabela e numrit të anëtarëve të fondit të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur

Emri i fondit të pensionit privat: **Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen**

Kodi i fondit të pensionit privat: **FP1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **30/09/2024**

Anëtarë sipas planeve të pensionit	Nr.i anëtarëve
Anëtarë sipas kontratave të pensionit privat	1395
Numri i anëtarëve (punëmarrës) me kontratë midis punëdhënësve dhe shoqërisë administruese	18
Numri i anëtarëve me kontratë individuale dhe me kontratë midis punëdhënësit dhe shoqërisë administruese	2953
Anetare Gjithsej	4,366

15. Tabela e numrit të anëtarëve të larguar nga fondi i pensionit privat

Emri i fondit të pensionit privat: **Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen**

Kodi i fondit të pensionit privat: **FP1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **30/09/2024**

Nr anetareve te larguar nga fondi	Nr.
për shkak se ka lindur e drejta për përfitim pensioni (tërheqje periodike e pensionit)	
për shkak se ka lindur e drejta për përfitim pensioni (tërheqje e menjëhershme e pensionit)	33
për shkak të largimeve të parakohshme	80
për shkak të ndryshimit të anëtarësisë/transferim	
Totali	113

11. Tabela e ndarjes së anëtarëve të fondi të pensionit sipas grupmoshave

Emri i fondit të pensionit privat: **Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen**

Kodi i fondit të pensionit privat: **FP1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **30/09/2024**

Ndarja e anëtarëve sipas grupmoshave	Nr.i anëtarëve
< 25 vjeç	82
25 vjeç - 30 vjeç	284
30 vjeç - 40 vjeç	1026
40 vjeç - 50 vjeç	1445
50 vjeç - 60 vjeç	685
> 60 vjeç	303
Anetare pa moshe te identifikuar	541
Totali	4366

17. Tabela e ndarjes së anëtarëve të fondit të pensionit privat sipas gjinisë

Emri i fondit të pensionit privat: **Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen**

Kodi i fondit të pensionit privat: **FP1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **30/09/2024**

Ndarja e anëtarëve sipas gjinisë	Nr.i anëtarëve
Femra	2548
Meshkuj	1818
Totali	4366

18. Tabela e numrit të anëtarëve që marrin pension privat periodik

Emri i fondit të pensionit privat: **Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen**

Kodi i fondit të pensionit privat: **FP1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **30/09/2024**

Emërtimi	Nr.i anëtarëve
Numri i anëtarëve që marrin pension privat periodik	16

19. Pasqyra e kontributeve të anëtarëve të fondit të pensionit

Emri i fondit të pensionit privat: **Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen**

Kodi i fondit të pensionit privat: **FP1**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **30/09/2024**

Gjendja e kontributeve të klienteve deri me 30.09.2024 (ne leke)	(ne leke)
Nga Anetare vullnetare	351,343,341.23
Punonjes + Punedhenes	1,173,170,604.19
Totali	1,524,513,945.42
Punonjes + Punedhenes:	
Kontributet e Punedhenesve	575,039,529.04
Kontributet e Punonjesve	598,131,075.15
Totali	1,173,170,604.19

Kontribute të derdhura nga 01.01.2024 - 30.09.2024 (ne leke)	(ne leke)
Nga Anetare vullnetare	47,500,970.07
Punonjes + Punedhenes	134,513,573.86
Totali	182,014,543.93
Punonjes + Punedhenes:	
Kontributet e Punedhenesve	68,053,837.44
Kontributet e Punonjesve	66,459,736.42
Totali	134,513,573.86

1. HYRJE

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin nr. 107 datë 18 tetor 2010, miratoi “Fondin e Pensionit Vullnetar Raiffeisen” nën administrimin e “Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a”.

Raiffeisen Invest -Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a, e përveç administrimit të fondeve të pensionit administron edhe sipërmarrjet e investimeve kolektive, aktualisht menaxhon vetëm një fond pensioni të quajtur “Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen”, i cili nuk është entitet ligjor dhe nuk ka personalitet juridik.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar gjithashtu First Investment Bank Albania sh.a. si bankë depozitare e Fondit të Pensionit Privat Raiffeisen. Shoqëria Administruese dhe Depozitari do të mbajnë aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta të ndara nga aktivet, veprimet dhe regjistrimet kontabël të Fondit të Pensionit Privat Raiffeisen.

2. BAZAT E PËRGATITJES

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe interpretimet e përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

b) Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike, me përjashtim të aktiveve financiare për tregtim, të cilat janë matur me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes.

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “Lek”, e cila është monedha funksionale dhe prezantuese.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në këto pasqyra financiare.

- **Aktivet dhe detyrimet financiare**

Fondi klasifikon aktivet financiare në kategoritë: me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes, të mbajtura deri në maturim, të vlefshme për shitje dhe llogari të arkëtueshme.

i Njohja

Aktivet financiare njihen në pasqyrën e pozicionit financiar në ditën kur entiteti bëhet pale kontraktuale në lidhje me një instrument në përputhje me blerjen e rregullt të tij. Një mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje e një instrumenti financiar njihet si data kontabilizimi të aktivitetit, datën e shlyerjes. Data e shlyerjes është dita kur aktivi i levrohet entitetit. Data e shlyerjes i referohet a) njohjes së aktivitetit në ditën kur ai merret nga entiteti b) c'regjistrimit të aktivitetit dhe njohjes së fitimit/humbjes neto nga shitja në ditën kur ai levrohet/dergohet nga entiteti. Kur aplikohet data e shlyerjes, entiteti kontabilizon çdo ndryshim në vlerën e drejtë të aktivitetit gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes. Me fjalë të tjera, ndryshimi në vlerë nuk njihet për aktivet të mbajtura me kosto ose kosto të amortizuara; por njihet si fitim ose humbje për aktivet e klasifikuara si aktive financiare të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes; dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse për aktivet e vlefshme për shitje.

Detyrimet njihen fillimisht në datën kur entiteti bëhet palë e kontratës.

ii Ç'regjistrimi

Fondi c'regjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të parase nga aktiviteti financiar, ose kur të drejtat për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale të aktivitetit financiar janë transferuar në një transaksion me të cilin transferohen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar. Fondi nuk njihet një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përbushur, ndërprerë apo kanë përfunduar.

Fondi merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në të gjitha ose kryesisht në të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha ose kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivet e transferuara nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar. Në transaksionet në të cilat Fondi as nuk mban dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivet financiare, aktiviteti ç'regjistrohet nëse kontrolli mbi to humbet.

iii Matja e vlerës së drejtë

Pas njohjes fillestare të gjitha aktivet financiare (përveç atyre të mbajtura deri në maturitet) maten me vlerën e drejtë. Përkufizimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është përcaktuar duke përdorur teknika të vlerësimit. Metodën e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të skontuara dhe krahasimin me instrumente të tjerë të ngjashëm, për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi. Ndryshimet në vlerën e drejtë janë njohur menjëherë në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Në çdo datë raportimi Fondi vlerëson, nëse ka një evidencë objektive që aktivet financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim - humbjes, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që ngjarja që sjell humbje ka ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

v. Investime të mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet të fiksuar që Shoqëria ka synimin e qartë dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose në dispozicion për shitje. Investimet e mbajtura deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çdo shitje ose riklasifikim i shumave të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim që nuk janë afër maturimit të tyre do të rezultonte në riklasifikimin e të gjithë investimeve të mbajtura deri në maturim si të disponueshme për shitje, dhe do të parandalonte Kompaninë të klasifikonte letrat me vlerë për qëllime investimi si instrumenta të mbajtura deri në maturim për periudhën aktuale dhe gjatë dy viteve financiare pasuese.

vi. Investimeve të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Fondi mban disa instrumenta me vlerën e drejtë, me ndryshimet e vlerës së drejtë të njohura menjëherë në fitim ose humbje, siç përshkruhet në politikën kontabël 2 (c) (iii). Një prezantim të detajuar të matjeve të vlerës së drejtë mund ta gjeni në shënimin 6 dhe 7.

- **Paraja dhe ekuivalentët e saj**

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë aktive financiare me shkallë likuiditeti të lartë me maturitet më të vogël se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Fondi për administrimin e angazhimeve afat-shkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto të amortizuar.

- **Llogaritë e arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme njihen në fillim në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e drejtë dhe maten në vazhdim me kosto të amortizuar, duke i zbritur zhvlerësimin.

- **Llogaritë e arkëtueshme dhe pagueshme nga letrat me vlerë.**

Llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme të cilat përdoren në momentin e blerjes dhe shitjes së letrave me vlerë janë njohur si aktive dhe detyrime në datën e transaksionit, datë e cila është e njëjtë me atë të pagesës.

e) Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme janë mbajtur me kosto të amortizuar.

4. STRATEGJIA E INVESTIMEVE TË ASETVE TË FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT RAIFFEISEN.

Strategjia e investimeve të aktiveve të Fondit të Pensionit Privat Raiffeisen mbështetet në ligjin nr 76/2023 “Per Fondet e Pensionit Privat” dhe rregulloret e dala në zbatim të tij, si dhe në politikën e brendshme të investimit të shoqërisë administruese, propozuar nga Komiteti i Investimit dhe miratuar nga Këshilli i Administrimit të shoqërisë.

4.1 Kuadri ligjor

Në lidhje me investimet e aktiveve të Fondit, Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen sh.a i përmbahet ligjit nr. 76/2023, datë 20.10.2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, si dhe rregullores “Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të fondit të pensionit”, miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me vendimin e Bordit nr 1, datë 28.01.2010 (ndryshuar)

4.1.1 Investimet e lejuara

Sipas rregullores, asetet e fondit mund të investohen vetëm në instrumentet e mëposhtëm:

- bono thesari, obligacione, dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Republika e Shqipërisë;
- bono thesari, obligacione, dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga një shtet anëtar i BE-së ose i OECD-së ose nga bankat qendrore përkatëse;
- bono thesari, obligacione, ose letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore;
- depozita bankare në banka të licencuara
- letra borxhi të klasifikuara si BBB ose më të lartë, sipas Standard & Poor’s ose Fitch, Baa3 ose më të lartë sipas Moody’s ose BBB (e ulët) ose më të lartë sipas DBRS (Dominion Bond Rating Service);
- aksione ose kuota të fondeve të investimit të licencuara në një shtet anëtar të BE-së dhe që kanë si qëllim të vetëm investimin në indekset në vijim: CAC 40, DAX, FTSE 100, S&P 500, Mesatarja Industriale e Dow Jones, Nikkei 225 (Japoneze), Sensex (Indiane), All Ordinaries (Australiane) dhe Indeksi Hang Seng (Hong Kong), ose në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së.

4.1.2 Kufizimet e investimit dhe kufiri i lejuar

Asetet e fondit nuk mund të investohen më shumë se:

- 100% në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Republika e Shqipërisë;
- 20% në depozita bankare në të njëjtën bankë;
- 30% në letra borxhi të klasifikuara si BBB ose më të lartë, sipas Standard & Poor’s ose Fitch, Baa3 ose më të lartë sipas Moody’s, ose BBB (e ulët) ose më të lartë sipas DBRS (Dominion Bond Rating Service), por jo më shumë se 10 %, në një emetues të vetëm;
- 30% në aksione ose në kuota të fondeve të investimit të licencuara në një shtet anëtar të BE-së dhe:

- që asetet e tyre investohen në indekset në vijim: CAC 40, DAX, FTSE 100, S&P 500, Mesatarja Industriale e Dow Jones, Nikkei 225 (Japoneze), Sensex (Indiane), All Ordinaries (Australiane) dhe Indeksi Hang Seng (Hong Kong); ose
- që asetet e tyre investohen në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së;
- 100% në obligacione, bono thesari ose në letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore;
- 100% në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së ose të OECD-se ose nga bankat qendrore përkatëse, por:
 - jo më shumë se 30% në një emetues të vetëm.
 - kufiri rritet deri në 100% në një emetues të vetëm, pas miratimit nga AMF, sipas argumenteve të dhëna për një politikë të tillë investimi.

4.1.3 Investimet e ndaluara

Shoqëria Administruese duhet t'i përmbahet ligjit për të mos i investuar asetet e "Fondi te Pensionit Privat Raiffeisen" në instrumentat e mëposhtëm:

- aksione, obligacione dhe letra të tjera me vlerë, që nuk janë të listuara ose që nuk tregtohen në bursë, në tregun ndërbankar apo në tregje të tjera, të rregulluara nga autoriteti përkatës;
- asete, që nuk mund të shiten ose transferohen;
- instrumente derivative, përveç rasteve për mbrojtjen nga rreziku i kursit të këmbimit apo nga rreziqe të ngjashme;
- asete fizike, që nuk kuotohen në mënyrë të rregullt në tregje të organizuara dhe për të cilat vlerësimi është i pasigurt, si, antika, punime arti, mjete motorike etj;
- aksione, obligacione dhe letra të tjera me vlerë, të emetuara nga:
 - çdo aksionar i shoqërisë administruese;
 - depozitari i fondit të pensionit;
 - çdo person, palë e lidhur me aksionarin e shoqërisë administruese dhe me depozitarin e fondit të pensionit;
 - kuota të fondeve të investimeve, që administrohen nga vetë shoqëria administruese;
- letra borxhi, të emetuara nga vetë punëdhënësi.

4.2 Politika e brendshme e investimit e shoqërisë administruese

Shoqëria e administrimit i kushton një rëndësi të vecantë shpërndarjes së aseteve, duke e konsideruar si vendimin kryesor në procesin e investimit. Synimi është krijimi i një portofoli investimesh miks, në mënyrë që të arrihet ekuilibri optimal midis kthimit nga investimi dhe riskut të tij. Objektivat afatgjatë për shpërndarjen e aseteve të Fondit janë si më poshtë:

SHPËRNDARJA E ASETEVE TË FONDIT			
Instrumenti	Minimumi	Objektivi	Maksimumi
Tituj të emetuar dhe garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë	50%	95%	100%
Tituj të emetuar dhe garantuar nga shtete të Bashkimit Europian, OECD-se, Banka Botërore, Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve	0%	0%	100%
Depozita bankare dhe cash	0%	5%	100%
Instrumenta borxhi me rating BBB (S&P), Baa3 (Moody's), BBB (DBRS)	0%	0%	30%
Kuota të Fondeve të Investimit ose indekse aksionesh: CAC 40, DAX, FTSE, S&P 500, Dow Jones, Nikkei 225, Sensex, All Ordinaries and Hang Seng	0%	0%	30%

Aktualisht, për të ruajtur anëtarët e Fondit nga risku i kursevë të këmbimit dhe duke qënë se tregu shqiptar është ende në zhvillim dhe pa një Bursë të mirëfilltë, i gjithë portofoli i Fondit përbëhet nga bono thesari dhe obligacione të Qeverisë shqiptare.

Risku i investimit merret përsipër vetëm nga anëtarët e Fondit dhe jo nga shoqëria administruese. Për të minimizuar këtë risk, shoqëria administruese ka në strukturën e saj organizative një Komitet Investimi i cili propozon politikat e shpërndarjes së asetëve dhe të investimit dhe një njësi të Manaxhimit të Riskut që kryen kontrollin sasior e cilësor të të gjitha llojeve të risqeve që lidhen me Fondin e pensionit.

Nuk janë të pranueshme ato investime ku kthimi është nën nivelin e tregut, pasi kompromentojnë ekuilibrin kthim nga investimi-risk.

- **Vlera Neto e Aktiveve të Fondit të Pensionit Privat Raiffeisen**

Vlera e aktiveve neto është e barabartë me totalin e aktiveve neto minus detyrimet e Fondit.

- **Vlera e kuotës së Fondit të Pensionit Privat Raiffeisen.**

Vlera e kuotës është e barabartë me vlerën e aktiveve neto të Fondit pjesëtuar me numrin e kuotave në datën e raportimit. Vlera fillestare e kuotës ka qënë e barabartë me 1000 Lekë, në përputhje me politikën e Fondit.

- **Të ardhurat nga interesat**

Të ardhurat nga interesat përfshijnë të ardhurat nga interesat e kuponave të obligacioneve dhe interesat nga depozitat. Të ardhurat nga interesat janë regjistruar sipas parimit të interesave të përlogaritura.

- **Tarifa për shoqërinë administruese.**

Fondi i detyrohet t'i paguajë shoqërisë administruese një tarifë prej 1.5% (në bazë vjetore) të aktiveve neto , shpenzim për Fondin i cili përlogaritet në bazë ditore. (2023-1.5%)

- **Fitim/ humbje të realizuara**

Të ardhurat/humbjet e realizuara ndodhin për shkak të shitjes së letrave me vlerë me diferencë nga çmimi i ofruar me vlerën e principaleve dhe interesave të maturuara në letrat me vlerë të blera me

premium ose discount. Këto fitim/humbje transferohen në të ardhura dhe shpenzime në momentin kur ndodhin.

- **Fitim/ humbje të parealizuara**

Fitim/humbje të parealizuara janë njohur si diferencë ndërmjet kostos dhe vlerës së drejtë të një letre me vlerë. Kur letra me vlerë shitet vlera e fitim/humbjeve të parealizuara transferohet në fitim/humbje të realizuara të periudhës.

- **Transaksionet me palët e lidhura**

Palë të lidhura me Fondin konsiderohen ato palë të cilat kanë një influencë dhe kontroll në vendimet financiare dhe operacionale të Fondit.

Palë të lidhura me Fondin janë: Raiffeisen Invest sh.a, e cila administron Fondin, Depozitari i cili kontrollon mirë-administrimin e Fondit si dhe Raiffeisen Bank sh.a. në cilësinë e aksionarit të Shoqërisë Administruese.

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

(a) Të përgjithshme

Përdorimi i instrumentave financiare e ekspozon Fondin ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional
- rreziku i shlyerjeve në shuma të mëdha
- rreziku rregullator
- rreziku i mos-diversifikimit
- rreziku i palës tjetër
- rreziku i performancës
- rreziku i inflacionit
- rreziku i personelit kyç
- rreziku i vleresimit të asetëve

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Fondit ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe procedurat për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut.

Struktura e administrimit të rrezikut

Sipas ligjit nr.76/2023 datë 20 tetor 2023 “Mbi fondet private të pensioneve”, Shoqëria administruese duhet të ketë një funksion për administrimin e rrezikut. Aktualisht ky funksion mbahet nga Drejtori i Menaxhimit të Risk-ut.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga institucioni financiar, për të vendosur kufizime dhe kontrole dhe për të monitoruar zbatimin

e këtyre kontrolleve. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut. Shoqëria përmes standardeve dhe procedurave administrative synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin çdo punonjës të kuptojë rolin dhe detyrat e tij.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare nëse emetuesi i instrumentit financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Fondi është i ekspozuar ndaj këtij rreziku në rast se qeveria shqiptare has vështirësi në përmbushjen e shlyerjeve të detyrimeve të saj ndaj mbajtësve të letrave me vlerë të emetuara prej saj.

Investimet në letra me vlerë sipas kategorisë së vendit janë detajuar si më poshtë:

	Letra me vlerë të tregtueshme	
	30 shtator 2023	30 shtator 2024
	Në lekë	Në lekë
Pa vonesa dhe të pazhvlerësuar		
Afatshkurtra: norma BB- (Shqipëria) sipas Standard & Poor's	1,322,334,921	1,560,558,462
	1,322,334,921	1,560,558,462

Rrezikut i normave të interesit

Është rreziku që i vjen vlerës së portofolit të fondit si pasojë e paparashikueshmërisë së levizjes së normave të interesit në treg. Më konkretisht, ky rrezik vjen si pasojë e lëvizjes në kah të kundërt të çmimit të instrumenteve dhe normave të tyre të interesit. Kur normat e interesit rriten, çmimi i instrumenteve financiare bie, dhe anasjelltas. Bazuar në strategjinë e investimit të parashikuar, asetet e Fondit do të investohen në instrumente financiare, të cilët janë lirisht të tregtueshëm çmimi i të cilave mund të ndryshojë çdo ditë.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që asetet e Fondit të mos shiten në kohë dhe me vlerën e tregut si pasojë e mungesës së likuiditetit në treg. Në këtë rast Fondi mund të hasë vështirësi për të shlyer detyrimet financiare në kohën e duhur.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, normat e kursit të këmbimit dhe normat e kredive, do të ndikojnë në të ardhurat e Fondit apo vlerën e instrumentave financiarë. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të manaxhojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

Rrezikut i kursit të këmbimit

Fondi nuk është ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës pasi transaksionet në monedhë të huaj nuk kanë ndodhur.

Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë, apo të tërthortë që vjen si rezultat i gabimeve njerëzore ose të sistemeve brenda shoqërisë administruese, nga ekzistenca e proceseve

të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose te dokumentacionit, si dhe nga procedurat e tregimit, te vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit.

Objektivi i Shoqërisë është të manaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare nëpërmjet procedurave të kontrollit të cilat kufizojnë ekspozimit ndaj këtij rreziku.

Rreziku i shlyerjeve të mëdha

Shlyerja e shumave të mëdha krahasuar me madhësinë e fondit mund të ketë efekt negativ në performancën e Fondit, sepse mund të jetë i detyruar që të shesë një instrument financiar në mënyrë të parakohshme, çka mund të rezultojë në humbje dhe rënie të cmimit të kuotës.

Rreziku rregullator

Rreziku rregullator lidhet me mundësinë e ndryshimeve të kuadrit rregullator, përfshirë legjislacionin tatimor. Vlera e aseteve të Fondit mund të ndikohet negativisht nga shfaqja e pasigurive në vendet ku janë bërë investimet, të tilla si tendencat politike ndërkombëtare, ndryshime në politikat e qeverisë, ndryshime në legjislacionin tatimor etj

Rreziku i mos-diversifikimit

Duke qenë se Fondi do të investojë kryesisht në Letra me Vlerë të Qeverisë, ai do të ketë një nivel të kufizuar diversifikimi dhe për rrjedhojë, mund të jetë më i ndjeshëm ndaj ndryshimeve ekonomike, politike, të biznesit ose të tjera që prekin emetues ose investime të ngjashme, krahasuar me një fond të diversifikuar. Kjo mund të rezultojë në një luhatje më të madhe të vlerës së kuotave të Fondit dhe rreziku i humbjes mund të jetë më i madh.

Rreziku i palës tjetër

Ky është rreziku që pagesa në një sistem transfertash të mos kryhet ose të kryhet me vonesë. Ai lidhet me moszbatimin e kushteve të një marrëveshjeje të paracaktuar, p.sh. mospagesën tek shitësi ose mosdorëzimin e objektit të marrëveshjes tek blerësi.

Rreziku i Performancës

Performanca e Fondit mund të devijojë nga pritshmëritë dhe një performancë pozitive nuk mund të garantohet nga shoqëria administruese.

Rreziku i inflacionit

I quajtur ndryshe rreziku i fuqisë blerëse, ky është rreziku që ndryshimet në të ardhurat reale të një investitori, pasi i ka përshtatur ato me nivelin e inflacionit, të jenë negative. Ky rrezik tregon se norma e inflacionit tejkalon normën e kthimit nga investimi. Si rrjedhim, investitori mund të pësojë realisht humbje edhe pse ai / ajo mund të ketë patur fitim në terma absolutë.

Rreziku i personelit kyc

Performanca e Fondit, pjesërisht i atribuohet aftësive profesionale të personave përgjegjës në shoqërinë administruese dhe vendimarrjes së duhur nga ana e administratorëve. Por, duke qenë se stafi i shoqërisë administruese mund të ndryshojë, vendimarrja e re mund të rezultojë më pak e suksesshme.

Rreziku i vlerësimit të aseteve

Ky lloj rreziku është tipik për tregjet jo likuide ose për tregjet që përballen me kriza financiare dhe humbje të besimit. Nëse investitorët njëkohësisht kërkojnë të shlyejnë një numër shumë të madh kuotash në Fond, shoqëria administruese mund të jetë e detyruar të shesë letra me vlerë nga portofoli i Fondit, me një çmim të ndryshëm nga çmimi i vlerësimit të tyre.

6. TË TJERA

PARAJA DHE EKUIVALENTË TË SAJ

Paraja dhe ekuivalentët e saj janë mbajtur me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar dhe përbëhen nga:

	30 shtator 2023	30 shtator 2024
	Në lekë	Në lekë
Depozitë		
Llogari rrjedhëse në banken FIB në Lekë	10,266,706	9,853,557
Totali	10,266,706	9,853,557

7.LLOGARITË E ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme në Lekë janë detajuar si më poshtë:

	30 shtator 2023	30 shtator 2024
	Në lekë	Në lekë
Të arkëtueshme nga interesat e përlllogaritura të obligacioneve qeveritare	16,105,354	18,010,421
Totali	16,105,354	18,010,421

Zv.Administratore e Përgjithshme

Alketa Emini

Specialiste e Financës dhe Kontabilitetit

Ivana Karapici